

Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë përmes një konference për media iu është drejtuar besimtarëve mysliman të Kosovës me mesazh urimi me fillimin e muajit të Ramazanit.

Myftiu Tërnavë me këtë rast ka folur për të mirat dhe dobitë që sjell muaji i Ramazanit.

“Agjërimi për besimtarët është një ibadet që bartë në vete përkushtimin, vendosmërinë, bindjen, urtësinë, devotshmërinë, sinqeritetin, dashurinë, sakrificën, unitetin, tolerancën e mirëkuptimin, vlera këto që e ekuilibrojnë njeriun, e fisnikërojnë shoqërinë si dhe ndikojnë në reflektimin për hyjnoren, njerëzoren e humanen”, tha myftiu i Kosovës.

“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin besimtarët shtojnë ibadetet, rrisin ndershmërinë, rrisin kujdesin ndaj njëri-tjetrit, bëhen më humanë, më të dashur e më paqësor, më social, më familjar e më të devotshëm. E pikërisht këto janë fadiletet, të mirat, dobitë dhe synimet e agjërit të këtij muaji”, tha Tërnavë.

Muaji i Ramazanit fillon të shtunën (27 maj) dhe sipas kalendarit janë 29 ditë agjërim.

Dita e Fitër Bajramit është më 25 qershor.